



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 12 maj 2014
Nr.ref.:RK621/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI121/13

Parashtrues

Lumturije Morina

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të
Kosovës, Ac. nr. 1791/13, të 12 korrikut 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është znj. Lumturije Morina (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës), të cilën e përfaqëson z. Teki Bokshi, avokat nga komuna e Gjakovës (në tekstin e mëtejme: përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Kontestohet Aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 1791/13, i 12 korrikut 2013, të cilin parashtruesja e kërkesës pretendon se e ka pranuar më 1 gusht 2013 si dhe Udhëzimi Administrativ nr. 2008/02 për unifikimin e taksave gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 1791/13, të 12 korrikut 2013, i cili në procedurën përmbarimore ndaj parashtrueses së kërkesës në cilësinë e debitorit e refuzon ankesën e saj si të pabazuar dhe e vërteton Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, E. nr. 934/12, të 8 marsit 2013. Parashtruesja e kërkesës kërkon edhe vlerësimin e kushtetutshmërisë së Udhëzimit Administrativ nr. 2008/02 për unifikimin e taksave gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatë

5. Më 7 gusht 2013, parashtruesja e kërkesës parashtrroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 30 gusht 2013, Kryetari, me Vendimin nr. GJR. KI121/13, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI121/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.
7. Më 18 shtator 2013, Gjykata informoi përfaqësuesin e parashtrueses së kërkesës për regjistrim të kërkesës dhe kërkoi nga ai që të nënshkruajë formularin zyrtar të kërkesës, pasi që formulari i dorëzuar më 7 gusht 2013 nuk ishte i nënshkruar nga ai.
8. Përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës nuk i është përgjigjur kërkesës së Gjykatës.
9. Më 21 shkurt 2014, Gjykata kërkoi nga përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës që të dorëzonte në Gjykatë të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me kërkesën e parashtrueses së kërkesës.
10. Më 4 mars 2014, përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës dorëzoi në Gjykatë formularin e Gjykatës të nënshkruar nga ai.

11. Më 25 mars 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Në bazë të dokumentacionit jo të plotë, të cilin e ka dorëzuar parashtruesja e kërkesës në Gjykatë, dhe i cili është i lidhur vetëm me procesin përmbarimor, Gjykata ka arritur deri te këto fakte.
13. Parashtruesja e kërkesës ka parashtruar ankesë në Gjykatën Themelore në Gjakovë ndaj Aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit, E nr. 934/12, të 1 marsit 2013, ku parashtruesja paraqitet në cilësinë e debitorit.
14. Më 8 maj 2013, Gjykata Themelore në Gjakovë, duke vendosur në bazë të ankesës së parashtrueses së kërkesës ndaj Aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit, E nr. 934/12, të 1 marsit 2013, refuzon ankesën si të pabazuar dhe konsideron se parashtruesja ankesën e ushtruar kundër Aktvendimit E nr. 934/12, të 1 marsit 2013 (Aktvendimi E nr. 934/12, të 1 marsit 2013 nuk gjendet në shkresat e lëndës) , e ka tërhequr në tërësi. Gjykata më tej thekson:

“Debitorja nuk i ka bashkëngjitur ankesës, dëshminë mbi pagesën e taksës. ... meqenëse debitorja brenda afatit nga konkluzioni i dt 22.03.2013 nuk e ka paguar taksën gjyqësore, në kuptim të nenit 19 të LPK-së, dhe nenit 102 të LPK-së, u vendos si në diapozitiv të këtij aktvendimi”.

15. Më 12 korrik 2013, Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vepruar në bazë të ankesës së parashtrueses së kërkesës, nxori Aktvendimin Ac. nr. 1791/13, duke refuzuar si të pabazuar ankesën. Gjykata, më tej në arsyetimin e saj, shton:

“[...] kjo gjykatë konsideron se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorës, sepse duke u bazuar në dispozitën e nenit 2.2 të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/02 për unifikimin e taksave Gjyqësore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.... ndërsa me dispozitën nenit 6.5 të udhëzimit të sipërpërmendur parashihet se nëse ata (taksat) nuk paguhen deri në datën përfundimtare, gjykata do ta hudhë poshtë parashtruesën për të cilën nuk janë paguar taksat, e që në rastin konkret ajo është taksë gjyqësore për ankesë nga neni 10.11 i këtij Udhëzimi”.

[...]

“Gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë as shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesja pretendon që me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 1791/13, të 12 korrikut 2013, i janë shkelur të drejtat e mbrojtura me Kushtetutë, si në vijim:

Neni 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe i Instrumenteve Ndërkombëtare], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

dhe konkretisht të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me Konventën Evropiane për Mbrotjtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe të protokolleve të saj, posaçërisht të Protokollit 1, nenit 1.

17. Parashtruesja, më tej, thekson:

“Taksat gjyqësore dhe detyrimet fiskale mund të përcaktohen ekskluzivisht me ligj... e assesi me Udhëzimin Administrativ nr. 2008/02 për unifikimin e taksave gjyqësore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës”.

18. Parashtruesja përfundon duke kërkuar nga Gjykata Kushtetuese që:

- *“të anuloj Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjykatë E nr. 934/12 të datës 08.05.2013*
- *Aktvendimin e Gjykatës së Apelit Ac. nr. 1791/13 të datë 12.07.2013, dhe*
- *të anuloj Udhëzimin Administrativ nr. 2008/02 për unifikimin e taksave gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës”.*

Pranueshmëria e kërkesës

19. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtrueses, Gjykata para së gjithash duhet të vlerësojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

Pretendimi përkitazi me kërkesën për anulimin e Udhëzimit Administrativ nr. 2008/02 për unifikimin e taksave gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës

20. Lidhur me kërkesën e parashtrueses për anulimin e Udhëzimit Administrativ nr. 2008/02 për unifikimin e taksave gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Gjykata i referohet nenit 113, paragrafëve 1, 2 dhe 7 të Kushtetutës, i cili përcakton që:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

2. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet si në vijim:

(1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën

(2) përputhshmëria e Statutit të Komunës me Kushtetutën”

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë,

mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

21. Për sa i përket kërkesës së parashtrueses që Gjykata të anulojë Udhëzimin Administrativ nr. 2008/2 për unifikimin e taksave gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Gjykata thekson se vetëm palët e autorizuar sipas nenit 113.2 të Kushtetutës, kanë të drejtë të parashtrojnë pyetjen e përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën. Prandaj, parashtruesja e kërkesës nuk është palë e autorizuar sipas nenit 113.2 të Kushtetutës (shih Rastin KI34/11, parashtrues Sami Bunjaku, Aktvendim për papranueshmëri i Gjykatës Kushtetuese, i 8 dhjetorit 2011.

Pretendimi përkitazi me vendimet e Gjykatës Themelore në Gjakovë dhe Gjykatës së Apelit të Kosovës

22. Në lidhje me pretendimet e parashtrueses që Gjykata Themelore në Gjakovë dhe Gjykata e Apelit e Kosovës përmes aktvendimeve të tyre kanë shkelur të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutë, parashtruesja duhet të vërtetojë që ka përmbushur kërkesat e parapara me nenet 113.7 të Kushtetutës, si dhe nenin 47.2 dhe 49 të Ligjit. Mund të shihet nga shkresat e rastit që parashtruesja ka paraqitur fakte që i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjeve në fuqi dhe se kërkesa është dorëzuar brenda afatit katër (4) mujor, siç përcaktohet me Ligj dhe me Rregullore të punës.

23. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (2) të Rregullores së punës, i cili përcakton që:

“(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...], ose

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

[...], ose

(d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij;”

24. Parashtruesja nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi *prima facie* që do të vërtetonte shkeljen e të drejtave të tyre sipas Kushtetutës (shih, *mutatis mutandis*, Vanek kundër Republikës Sllovaqe, nr. 53363/99, Aktgjykimi i 31 majit 2005). Parashtruesja nuk argumenton si në çfarë mënyre i janë shkelur neni 22, neni 31 dhe neni 54 i Kushtetutës dhe Protokollin 1, neni 1.

25. Parashtruesja e kërkesës nuk ka arritur të dëshmojë se në çfarë mënyre mospagesa e taksës gjyqësore ka sjellë deri në shkeljen e të drejtave të saja kushtetuese.

26. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese rithekson që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, që të veprojë si Gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i këtyre të fundit që t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës, nr. 30544/96,

GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11 të parashtruesve Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima, Aktvendimi për papranueshmëri, i 7 shkurtit 2011).

27. Gjykata Kushtetuese mundet vetëm të trajtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre janë kryer në mënyrë të tillë sa që parashtruesja të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, *inter alia*, Komisioni Evropian për të Drejta të Njeriut, Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, App. nr. 13071/87, 10 korrik 1991).
28. Për të gjitha arsyet e lartpërmendura, Gjykata është e bindur që faktet e dorëzuara nga parashtruesja nuk kanë arsyetuar në asnjë mënyrë pretendimin e shkeljes së të drejtave kushtetuese dhe parashtruesja nuk i ka mbështetur sa duhet pretendimet e saj.
29. Gjykata gjeti se kërkesa nuk i përmbush kriteret për pranueshmëri, të kërkuara me nenin 113.1 të Kushtetutës dhe me rregullin 36 (2), b) dhe d) dhe 36 (3), c) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.1 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe rregullit 36 (2) b) e d) dhe 36 (3) c) të Rregullores së punës, më 25 mars 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe,
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani